L I G J
Nr. 8932, datë 25.7.2002

PËR DËRGIMIN E NJË FORCE USHTARAKE SHQIPTARE NË AFGANISTAN, NË KUADËR TË KOALICIONIT NDËRKOMBËTAR KUNDËR TERRORIZMIT

Në mbështetje të neneve 12 pika 3, 78, 81 pika 1, 83 pika 1 dhe 84 pika 4 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I :

Neni 1

Dërgohet në Afganistan, si kontribut i Republikës së Shqipërisë, një togë e Batalionit Special Komando të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, në kuadër të koalicionit ndërkombëtar kundër terrorizmit.

Neni 2

Me vendim të Këshillit të Ministrave, ushtarakëve në përbërje të togës u përcaktohet gjatë ditëve të misionit, përveç pagës mujore dhe vështirësisë së shërbimit, një shpërblim ditor, trajtim dhe përballim të shpenzimeve për kompensimin e pasojave që vijnë për shkak të detyrës.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekretin nr. 3426, datë 7.8.2002 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu